



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:117826

Datë: 13.02.2025

Numri i dokumentit: 06847943

P.2024:229406

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA NË KAÇANIK, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal, Gjyqtari Burim Çaka, në lëndën penale kundër të pandehurit A. L, i akuzuar për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.721/22 të datës 06.07.2022, sipas detyrës zyrtare, më datë 13.02.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.721/22 të datës 06.07.2022, dhe PUSHON procedura penale ndaj të pandehurit A. L për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.

II. Shpenzimet e procedurës bien në ngarkim të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP.nr.721/22 të datës 06.07.2022, kundër të pandehurit A. L, i akuzuar për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së dhe të pandehurve E. L dhe V. L për veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata me aktvendimin procedural P.2022:139032 të datës 21.08.2024 e ka veçuar procedurën penale ndaj të pandehurit A. L, për të cilin është krijuar dosja aktuale P.2024:229406.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të shkresa të lëndës për lëshimin e letër rreshtimit ndërkombëtar ka konstatuar si vijon:

Gjykata ka konstatuar se i pandehuri nuk është marrë në pyetje në Prokurori sipas nenit 151 paragrafi 2 të KPP-së – (Kodi nr. 04/L-123 i procedures penale)

Sipas vlerësimit të gjykatës, bazuar në dispozitën e nenit 151 paragrafi 2 të KPP-së (Kodi nr. 04/L-123 i procedures penale), i cili ka qenë në fuqi në kohën kur është ngritur aktakuza në paragrafin 2 parashihet: *Para ngritjes së aktakuzës, i pandehuri merret në pyetje në seancën e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake....*

Gjykata ka vlerësuar se kjo dispozitë ligjore neni 151 paragrafi 2 të KPP-së (Kodi nr. 04/L-123 i procedures penale) *nuk është respektuar në rastin konkret*, pasi që për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, parashihet dënimi me burgim prej 6 muaj deri në pesë (5) vjet, në këtë rast ka qenë obligative nga ana e Prokurorisë që i pandehuri *të merret në pyetje në seancën e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake para prokurorit të shtetit para se të ngritet aktakuza.*

Bazuar në nenin 152 paragrafi 1 të KPP-së (Kodi nr. 04/L-123 i procedures penale), të pandehurin e merr në pyetje prokurori i shtetit. Prokurori i shtetit ka pasur të drejtë që marrjen në pyetje mund t'ia besojë policisë me autorizim.

Bazuar në nenin 104 paragrafi 4 të KPP-së (Kodi nr. 04/L-123 i procedures penale) Prokurori i shtetit mund të ndërmerr veprime hetimore ose të autorizojë policinë që të ndërmerr veprime hetimore lidhur me mbledhjen e provave. Ku prokurori i shtetit ka pasur mundësi që pas fillimit formal të hetimeve sipas Aktvendimit të Fillimit të hetimeve në këtë rast të nxjerr më datë 07.06.2022 ka mundur që vet ose ta autorizoj policinë që ta merr në pyetje të pandehurin, e cila në rastin konkret nuk e ka zbatuar edhe këtë dispozitë ligjore, ku i pandehuri është marrë në pyetje më datë 12.05.2022 në cilësinë e të dyshuarit para se të fillojnë fomalisht hetimet sipas Aktvendimit mbi fillimin e hetimeve i cili është nxjerr nga Prokuroria me datë 07.06.2022,

mirëpo që kjo deklaratë nuk përmbush kushtet dhe rregullat ligjore, për tu konsideruar si deklaratë e rregullt në procedurën penale, kjo pasi që i pandehuri në këtë fazë penale është marrë në pyetje në cilësi të dyshuarit, pra para se të filloj procedura penale sipas aktvendimit mbi fillimin e hetimeve.

Lidhur me këtë rast, e njëjta gjen mbështetje edhe vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. Pml.nr.343/2023 të datës 22.07.2024 (2023:150869), e cila ka konstatuar se mos marrja në pyetje e të pandehurit gjatë seancës së marrjes së deklaratës, bie ndesh me parimet kryesore të procedurës penale dhe atë parimin e kontradiktoritetit dhe parimin e barazisë së armëve, meqë të pandehurit në këtë mënyrë, i pamundësohet e drejta që të njihet me rezultatin e hetimeve dhe i mohohet e drejta e mbrojtjes, parime dhe të drejta që burojnë edhe nga neni 6 i KEDNJ-së "E drejta për një proces të rregullt".

Prandaj, bazuar në të lartë cekurat, konform nenit 357 paragrafi 1 nënpar.1.3 të KPP-së, hedhet aktakuza PP.nr.721/22 të datës 06.07.2022, kundër të pandehurit A. L për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, pasi që ekzistojnë rrethana që e pengojnë ndjekjen penale, meqë aktakuza është ngritur, pa i'u dhënë mundësia të pandehurit që të paraqesë mbrojtjen e tij.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 453 paragrafi 1 të KPRK-së.

Mbi bazën e arsyeve të cekura më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

**DEGA KAÇANIK**

P.2024:229406 datë 13.02.2025

Gjyqtari  
Burim Çaka

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.